




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR ARSIMIN DHE SPORTIN
DREJTORIA E PROGRAMIMIT, STANDARDIZIMIT DHE HARMONIZIMIT TË KUADRIT
RREGULLATOR



Nr. 3253/3 Prot.

Tiranë, më 29.5. 2025

Lënda: Dërgohet udhëzimi për njohje dhe zbatim.

QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr. 23 Tiranë, Albania

Bashkëlidhur ju dërgojmë për njohje dhe zbatim udhëzimin nr. 17, datë 26.05.2025 të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 21, datë 15.10.2021 "Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar", i ndryshuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 3253 / Prot.

Tiranë, më 26.05.2025

U D H Ë Z I M

Nr. 17, Datë 26.05.2025

P Ë R

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 21, DATË 15.10.2021 "PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE, GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË, TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONE TË HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË AUTORIZUARA", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 6, të nenit 92, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe urdhrit nr. 113, datë 26.3.2024 "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Ana Kapaj", i ndryshuar

U D H Ë Z O J:

1. Në udhëzimin nr. 21, datë 15.10.2021 "Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara", i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:
 - a) Në fund të shkronjës "b" të pikës 5, të kreut I, bëhet shtesa si më poshtë:
"... me përjashtim të diplomave/certifikatave profesionale, diplomave, gradave shkencore të lëshuara nga institucione të arsimit të lartë të vendeve BE-së, SHBA-së, Britanisë së Madhe, Kanada, Japoni, Norvegji, Izrael, Zvicër, Islandë, Australi dhe Turqi."
 - b) Paragrafi i dytë i shkronjës "a" të pikës 1, të kreut III, ndryshon si më poshtë:

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 23, AL 1001, Tiranë. E-mail: info@arsimi.gov.al www.arsimi.gov.al



“Përjashtimisht, procedura përfundon brenda 5 ditëve pune nga data e aplikimit, për diploma/certifikata profesionale të të gjitha formave të studimit të fituara në vendet e BE-së dhe SHBA-së, Britani e Madhe, Kanada, Japoni, Norvegji, Izrael, Zvicër, Islandë, Australi, si dhe Turqi në rast se diploma/certifikata profesionale dhe suplementi ose lista e notave të saj janë të pajisura me vulë apostile. Në rastet kur QSHA-ja evidenton parregullsi/mangësi në dokumentacionin e paraqitur, mund të nisë procesin e verifikimit të tij, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

- c) Në fund të fjalisë në shkronjën “a” të pikës 2, të kreut III, shtohen fjalët si më poshtë:
“... me përjashtim të programeve të studimit të përfunduara në institucionet e arsimit të lartë të vendeve BE-së, SHBA-së, Britanisë së Madhe, Kanada, Japoni, Norvegji, Izrael, Zvicër, Islandë, Australi dhe Turqi.”.
- d) Shtojca nr. 3, zëvendësohet me shtojcën nr. 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe komisionet përkatëse..

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”

ZËVENDËSMINISTRI

ANA KARAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Shtojca nr. 3

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE**

Nr. _____ prot., Nr. _____ Regjistri

Tiranë më _____._____

VËRTETIM NJOHJE DHE NJËSIMI

Vërtetohet njohja e diplomës/certifikatës së Z/Znj. _____ (emër atësi,mbiemër),
lëshuar nga _____ (institucioni që ka lëshuar diplomën/certifikatën), _____ (shteti),
më datë _____._____._____ (data e lëshimit të diplomës/certifikatës), me program _____ vjeçar
(kohëzgjatja e programit të studimit, _____ ECTS (numri i krediteve të fituara në rast kur këto
disponohen), me formë studimi _____ në (emërtimi i programit të studimit).

Kjo diplomë/certifikatë njësohet si _____ në Republikën e Shqipërisë.

Ky vërtetim është i vlefshëm, i shoqëruar me diplomën/ certifikatën e njohur dhe njësuar.

Drejtor i Përgjithshëm

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 23, AL 1001, Tiranë. E-mail: info@arsimi.gov.al www.arsimi.gov.al

